

	<b>KOMENTE</b>	<b>FO-ÇLRR-025</b>
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 1 nga 4</i>

03.03.2023

**Komente lidhur me: Raportin Konsultativ për MAR të KOSTT 2023-2027 dhe ndaj Planit  
Investiv 2023 - 2027**

*Çështja për komentim:*

- 1. Hyrje**
- 2. Kostot e Shërbimeve Ndhmëse**
- 3. Mekanizmi ITC**
- 4. Kostot e Humbjeve**
- 5. Kostot e Shpenzimeve Operative dhe të Mirëmbajtjes**
- 6. Kostot Kapitale**
- 7. Përshatjet e rregullta të vitit 2022 dhe PRR2**

*Komentimi:*

**1. Hyrje**

Duke u bazuar në Raportin Konsultativ për të Hyrat e Lejuara Maksimale në kuadër të PRR3 për periudhën 2023-2027, të pranuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë me datën 16 Shkurt 2023, KOSTT ka përgatitur komentet dhe kërkesat në disa prej pikave të cekura në raport.

**2. Kostot e shërbimeve ndihmëse**

KOSTT, si Operator i Sistemit dhe Transmetimit, është i pajisur me licencën e lëshuar nga ZRrE për operimin teknik të rrjetit të transmetimit dhe operimin e sistemit elektroenergjetik të Republikës së Kosovës. Në kuadër të detyrave për operimin e sistemit, KOSTT është i obliguar që në përputhje me Kodin e Rrjetit në fuqi, të siguroj operimin efikas të sistemit në kohë reale, duke balancuar SEE gjatë gjithë vitit, konkretisht qdo moment mbrenda 8760 orëve të vitit kalendarik. Balancimi në fjalë është i domosdoshëm për mundësimin e punës paralele me rrjetet e transmetimit të shteteve fqinje dhe atyre Europiane. Që kjo të arrihet është detyrë licensore e KOSTT që të siguroi produktet balancuese, konkretisht shërbimet ndihmëse si rregullimi sekondar aFRR dhe rregullimin terciar mRR, përmes të cilave produkte do të jet në gjendje të balancoi SEE të Kosovës në kohë reale.

Çmimi për kapacitet rezervë aFRR deri në muajin Mars 2021 kishte vlera fikse të nivelin 2.2 €/MWh. Nga data 01 Prill 2021 kur kapacitetet blehen në ankand nga OST, ato rriten me çmimet e ankandit në vlerat mesatare rreth 17 €/MWh gjatë vitit 2021, ndërsa në vitin 2022 kjo vlerë sillet mesatarisht rreth 20 €/MWh.

Duke e parë këtë trend të rritjes, vlera për Koston e Shërbimeve Ndhimese për vitet 2023 e tutje duhet të rritet në vlerat e parashikuara sipas KOSTT.

Kërkesa e KOSTT për vitin 2023 për Shërbimet Ndhimese është 13,000.000 €.

### 3. Mekanizmi ITC

Të hyrat nga transiti janë paraqitur në kontinuitet prej 1,363.000 € për të gjithë periudhën 2016-2022, që është vlerë shumë e madhe. Sa për krahasim gjeni në tabelën e mëposhtme të hyrat e netuara (parashenja +) dhe shpenzimet e netuara (parashenja -) nga transitit sipas viteve:

Tabela 2. Të Hyrat nga ITC 2016-2022

Vitet	NET TE HYRAT NGA ITC 2016 - 2022	Komente
2016	225,257.26	
2017	68,702.59	
2018	1,035,974.62	
2019	499,464.83	
2020	(28,128.59)	
2021	168,768.45	
2022	(640,746.77)	Të dhëna reliminare deri në qershor 2022

### 4. Kostot e humbjeve

Kostot e Humbjeve në Transmision për vitin 2022 kanë qenë 14,889.462 €. Vlera e Raportuar në Formularet Raportues të dërguar në ZRRE me datë 22 Nëntor 2022 prej 13,257.705 €, ka qenë vlerë e realizuar për dhjetë muaj dhe dy muaj planifikim.

### 5. Kostot e shpenzimeve tjera operative

Sipas raportit konsultativ të ZRRE, vlera bazë e Opex-it për vitin e parë të periudhës së ardhshme rregullative (PRR3) merr parasysh vlerën mbyllëse të Opex-it në vitin e fundit të periudhës së kaluar rregullative, për ta përshtatur pastaj sipas kostove jashtë kontrollit, detyrimeve ligjore, normës së inflacionit, faktorit të efikasitetit etj.

Në propozimin e ZRRE për vlerën e shpenzimeve tjera operative sipas vitit përmblyës të periudhës së kaluar rregullative, realizimi i shpenzimeve të personelit ka qenë në bazë të numrit mesatar prej 344 punëtorëve.

Bazuar në planin investiv për periudhën tarifore 2023-2027 do të funksionalizohen edhe 4 nënstacione të reja për të cilat sipas sistematizimit aktual duhet të punësohen nga 4 punëtorë për secilin nënstacion, me ç'rast do të ndikojnë në rritjen e numrit të punëtorëve nga viti 2024.

Ndërlidhur me rritjen e stafit sipas realizimit nga Planit investiv 2023-2027 propozoj që ZRRE të rishikoj mundësinë e rritjes së shpenzimeve tjera operative nga viti 2024 prej 5 - 6 % sipas tabelës.

Tabela 3. Shpenzimet operative sipas propozimit nga ZRRE dhe propozimit për rritje 5% viti 2024

Shpenzimet Operative	2023	2024	2025	2026	2027
Propozimi nga ZRRE për shpenzime tjera operative	7,075	6,969	6,865	6,762	6,660
Propozimi pas rritjes 5% nga viti 2024	7,075	7,317	7,208	7,100	6,993

## 6. Kostot kapitale 2023-2027

KOSTT në vitin në Planin Investiv 2023-2027 ka paraparë një vijë buxhetore prej 160,000 euro për projektin me ID 061: **Përmirësimi i Izolimit të Anës 220 kV në NS Kosova A**. Pasi vlera e paraparë në vitin 2022 prej 160, 000 euro nuk ka arritur të kontraktohet dhe ka dështuar si vije buxhetore kerkojm qe vlera e parapare ne planin investiv 2023-2027 të rritet për të njëjtën vlerë, pra edhe për 160, 000 dhe në total të jetë në vlerë prej 320,000 euro.

Kjo kërkesë është e natyrës emergjente për arsye se në stabilimentet 220 kV në NS Kosova A kemi pasur edhe me herët avari të ngjashme, rënia komplet e pajisjeve të anës 220 kV nga e cila mund të shkaktojnë edhe rënien e blloqeve të TC Kosova A, e që për pasojë mund të shkaktoj

çrregullimin e furnizimit me energji të mbarë konsumit në nivel të Republikës së Kosovës, gjë për të cilën mund të penalizohemi për shkaktim të këtij çrregullimi.

Duhet cekur që në këso raste për arsye të shkaktimit të jo balancit shkaktohen edhe dëme të konsiderueshme financiare që i adresohen KOSTT-it.

Rasti i fundit ka ndodhur më 27.02.2023 në ora 11:55 minuta ka rënë nga sistemi zbarra Zk1 në NS Kosova A ku si pasojë ka ardhur deri te rënia e booku A4 pas veprimit të mbrojtjes së zbarrave si rezultat i lidhjes së shkurtë në këtë zbarrë. Kjo ka ardhur si shkak i kapërcimit të tensionit në izolatorin tërheqës të fazës 4 në fushën transformatorike T-35. Rasti i njëjtë ka ndodhur edhe me datë 06.12.2021 me ç'rast ka ardhur deri te rënia e komplet anës 220 kV në NS Kosova A ku me këtë rast kanë rënë nga sistemi dy njësit e TC Kosova A A3 dhe A5. Raste të ngjashme të dështimit të izolimit ka ndodhur edhe në disa raste tjera por me pasoja më të vogla.

Dyshimet kryesore për këtë avari janë për shkak të dobësimit të izolimit në këtë nënstacion si rezultat i ndotjes së madhe që egziston në këtë lokacion si dhe tensioneve të larta që mbretërojnë në rrjetin tonë transmetues tash e një kohë. Kryesisht ky fenomen i avarive është më i theksuar në anën 220 kV nga ana ku gjendet kulla ftohëse e TC Kosova A me ç rast vazhdimisht i nënshtrohet lagështisë dhe krijon kushtet për dëmtim të izolimit dhe rënie të elementeve në sistem.

Marre parasysh faktoret e mësipërm gjasat për përsëritjen e avarive të tilla është permanente prandaj është nevojë urgjente ndërmarrja e hapave të menjëhershëm për parandalimin e këtij fenomeni në këtë nënstacion me pasoja shumë të mëdha.

KOSTT përmes këtij projekti ka paraparë furnizimin dhe montimin e izolatorëve 220 kV të qelqit ku është paraparë rritja e shkallës së izolimit, pra kalimi nga niveli aktual i izolimit në një nivel më të lartë të izolimit sipas standardeve teknike të aplikueshme dhe që do të siguronin operim të sigurt me nivel minimal rrezikshmërie për degradim të sistemit.

Me këtë rast kërkojmë nga ZRRE që të aprovohet kërkesa për lejimin e vijës buxhetore në shumën prej 320.000 Eurove të cilat mjete do të përdoren për realizimin e projektit në fjalë.

KOSTT ka argumentuar nevojën për zhvillimin e këtyre projekteve ashtu si edhe të gjitha projekteve tjera në planin investiv duke u bazuar në plotësimin e kërkesave të ligjeve dhe rregullave në fuqi, kriterit N-1, nevojave të konsumatorëve dhe zhvillimit ekonomik të Kosovës, nevojave të zhvillimit të rrjetit dhe përmirësimit në ato pjesë ku është i vjetërsuar etj.

## **7. Përshtatjet e rregullta të vitit 2022 dhe PRR2**

Në raport shihet se janë përfshirë të gjitha përshtatjet për PRR2 dhe përshtatjet e rregullta për vitin 2022, KOSTT ka analizuar me kujdes llogaritjet e tyre dhe nuk ka ndonjë vërejtje në këtë aspekt.